



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.795/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, në lëndën juridiko-penale ndaj të pandehurit Sh. K., nga L. rr. “H. B.”, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik na neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, të cilin e akuzon Prokuroria Themelore ne Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4731/17 të dt.22.11.2017, shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me 10.10.2018, në prani të Prokurororës së shtetit M. L., dhe mbrojtësi të t’pandehurit V. S. av. nga L., dhe të akuzuarit në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

Sh. K., nga i ati Xh., i lindur me datë *data e lindjes...*, në L. në rr. “H. B.” posedon patent shofer me nr. *numrti...*, si dhe letërnjoftimin me numër personal *nurmi personal...*, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 20.07.2017, rreth orës 13:20h, derisa i pandehuri Sh K drejtonte automjetin e tipit “Golf WV” me targa të regjistrimit *numri i targave...*, në rrugën “H. B.”, në L. i cili nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 151 par. 1 të LSKRR-së, nuk kishte përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit në rrugë, me ç’rast e godet këmbësoren fëmijën O. V., të cilës i kishte shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik na neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së,

Andaj gjykata konformë nenit 1, 2, 4, 6, 7, 17, 23,73, 85, 86, 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 dhe 498 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Të pandehurit Sh. K., nga L. rr.”H. B.”, i bëhet me dije se ka kryer një vepër të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryejnë persëri vepër të tillë, gjykata do t’i shqiptojë sanksion më të rendë penal.

E dëmtuara: O. V., me përfaqësuesin e saj ligjor E. B., udhëzohet që kërkesën pasuroro-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt gjyqësore civile.

DETYROHET i akuzuari në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajë, shumë prej 60.88-€, për paushall gjyqësor shumë prej 20-€, si dhe shumë prej 30-€, në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzen PP.II.nr.4731/17 të dt.22.11.2017, e ka akuzuar Sh. K., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik na neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti është bërë në bazë të dispozitave ligjore, me vullnet dhe pa presion andaj i propozoi gjykatës që të njëjtin ta pranoi vullnetare, pa presion dhe konform dispozitave nenit 248 KPRK-së, dhe i propozoi gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit, të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ngase se në ditën kritike e dëmtura nga pakujdesia ka vepruar në drejtim timin e cila më ka goditur anash e që nuk kam pasur mundësi ta ndali veturën, mirpo meqë është vendbanim dhe e dëmtuara është e mitur e kam pranuar fajësinë dhe njëherit kësaj gjykate i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla të ngjashme.

Mbrojtësi i të pandehurit pajtohet me pranimin e fajësisë se klientit të tij dhe i propozoi gjykatës që t'i shqipton një dënim sa më të butë, ngase klienti im për herëtë parë ka rënë ndesh me ligjin, i moshës së re, gjithashtu gjykatën e njoftoi se klienti im ka pranuar fajësinë pas konsultimeve me mua dhe pasi që paraprakisht ia kam shpjeguar beneficinet që i parashef ligji me rastin e pranimit të fajësisë, gjithashtu mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar si rrethanë letësuese gjykata i propozoi që të ketë parasyshë faktin e konstatuar nga eksperti i komunikacionit se klienti im ka kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti e që do të thotse i njëjti nuk është shkaktar kryesor porpër këtë pjesë të kontributit të shpallet fajtor, dhe mbrenda mundësive t'i shqiptohet një dënim sa më i lehtë e meqë një sanksion të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik na neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së

Me rastin e përcaktimit të llojit të dënimit dhe të lartësisë së tij gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj të pandehurit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi, moshën e re, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, dhe sinqeritetin e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra, pendimin, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do ta përsërisë një vepër të tillë të ngjashme, e veqanërisht pranimin e fajësisë, e në mungesë të rrethanave rënduese, gjykata konform nenit 4 të KPRK-së, ndaj të pandehurit ka vazhduar me shqiptimin e vërejtjes si në

dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se edhe me një lloj të veçantë të sanksionit verbal jondëshkues, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 85 të KPRK-së, që ka për qëllim ti jepet kryesit qortimi kur, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftushme për të arritur qëllimin e dënimit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 450 par. 2 pika 2.1 dhe pika 2.6 të KPPK-së, ku në këto shpenzime janë llogaritur shuma prej 20.-€, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shuma prej 20.-€ në emër të ekspertizës së komunikacionit shumen prej 40.88-€, si dhe shumen prej 30.-€, për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit bazohet në nenin 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

P.nr.795/17 të dt.10.10.2018.

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQ T A R

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së të njëjtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate..